



UNIVERSITÀ DELLA CALABRIA
DIPARTIMENTO DI LINGUE E SCIENZE DELL'EDUCAZIONE
LABORATORIO DI ALBANOLOGIA
UNIVERSITETI I KALABRISË
DEPARTAMENTI I GJUHËVET DHE I SHKENCAVET TË EDUKIMIT
LABORATORI I ALBANOLOGJISË



Opere di Francesco Antonio Santori

a cura di

Vincenzo Belmonte

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

NEOMEN'JA

Lettore benigno

In questo secolo, in cui tanti e sì vari sono i volumi con i quali ha voluto ciascun uomo manifestare pomposamente il suo ingegno, dimostrando la bella immensità dell'amenò giardino della ubertosa letteratura; dispersi nelle sue infinite strade, a guisa di numerosi mirmidoni, che stendono sentiero su d'una ampia spaziosa quercia; ove chi all'elsa tende e felicemente vi sale; chi ai rami piani, chi ai verticali cadenti, chi agli inclinati in alto, chi s'aggira nel tronco, ed altri finalmente cade nel suolo; tutti un piacer vario seguendo, sono non perciò partecipi di un medesimo frutto riposto o sull'interesse o sull'alloro. Veggonsi in lor mani le feconde scienze qui prestar matura frutta, là spiegarsi ancora verdeggianti¹ e altrove germogliate e cresciute a segno da prestare indizio di non potere inoltrarsino più. La Pittura, la Poesia, la Musica fanno rumore ed hanno applicato i talenti dei più nobili Signori, rese omai l'entusiasmo e lo spirito delle Città e dei Regni. La Fisica, la Chimica, la Legge, le nuove Invenzioni serpeggiano nella più grandiosa voga. La Scultura, l'Architettura, le belle arti, la razional Filosofia, sembra che a nuovo alloro non aspirano ed invidiose non si spiegano di novella palma. In un cumulo dunque così vasto di nobili ingegni, nel vastissimo pelago delle trattate idee, troppo difficile ed arduo sarà l'intraprendere una straordinaria fatica ed opporsi all'immortal fama di un Tasso, alla divina gloria di un Alighieri, all'incomparabile sonorità di un Ariosto, di un Petrarca, di un Alfiero, ché i nostri disegni, appo di questi pensieri alteri e spumosi, tronchi sariano, come i passi di Lucifero che, volendo troppo in alto salire, furiosamente giù funne precipitato. E quantunque, perché non si arrestano le scienze, potrà avvenire che un dì polverosi i loro volumi vanno in cerca della rugosa fronte di un logoro antico veglio, che con occhi malsani rumina gli annosi scartacci, e non della giovane posterità, pure ai nostri tempi non possono non essere l'oggetto stuporoso della nostra mira. Non è dunque di noi l'impresa. Adoriamoli e ci sia glorioso l'aver voluto tentare il loro cammino ed essere restati vittime di desiderio. Comprendi impertanto, illustre lettore, non esser stato mio scopo voler pompeggiare con una materia tutta nuova che avesse destato il piacere dei curiosi, ma piuttosto per dimostrare i pregi d'una favella tenuta tutt'ora come inutile e di nessun vantaggio, mentre buona parte occupa del Bisiciliano Regno ed altra pezza altrove. Mi son perciò indotto a combinare la presente operetta, qual è per altro tutta tratto di fantasia, onde restare invalido il detto di coloro che di nulla prezarono un tal Idioma. Questa mira prese ancora l'inclito giovinetto Signor de Rada, che, ancor di età fiorente ed acerba, ha dato buon saggio del suo nobile acuto ingegno con farci egli primo vedere in splendente albeggio questa favella nelle due operette pubblicate, cioè nel Milosao e nella Serafina Topia ancor seguente. E questo poi fia² ad immortal sua gloria, che accese l'animo nostro ed a scrivere lo indusse. Il Signor Varibobba avea dato un brevo³ crepuscolo per gli futuri annali di questa lingua, ma l'edace tempo e la non sequela tolse parte della sua fama. Ho voluto dunque nell'espore sott'occhio del mondo un tal Idioma aver riguardo, per quanto mi fu possibile, alla purità della favella, alla chiarezza nella connessione delle idee e dimostrar la lingua qual in sua natura è, senza alterarla con artificiosi raggiri per riuscire ottimo nell'Italiano; alla non complicazione con delle varie lettere forastiere, meno che di quelle [che] vi son d'uopo per necessità di mezzo, senza le quali non sarebbesi punto potuto scrivere, come sarebbero la *k* col valore che porterebbe nella parola *khaa*, voce prima del tempo presente dell'indicativo del verbo mangiare; *θom* del verbo dire, e questa nel valore e nella compositura appartiene all'Alfabeto Greco; *jym*, madre. Come debbano queste ed il resto dell'alfabeto pronunziarsi, hassi bisogno assolutamente della voce del Maestro, ed ogni mio sforzo indarno spento sarebbe. Ed essendo bastante questa nozione per poter leggere almeno gli intelligenti nazionali, per ora mi arresto, serbandomi a miglior tempo e più opportuno a' miei disegni con altra operetta dar le precise regole anco agli Italiani. Io ciò non pertanto non lascio mica di sottomettere la presente sotto quelle acute riflessioni e critiche ancora degli saggi albanesi, ove il mio intelletto non è raggiunto; anzi con il più vivace ridente desiderio gl'invito a riflettervi e far giungere le loro riflessioni nelle mie mani, acciò io possa correggere ed emendare, ove atto ne sia, e ridurre a miglior uopo col loro pro la lingua e la materia da me trattata. Ed io, mentre a tutti partecipo i più distinti ringraziamenti, caramente gli saluto, annunziando loro un'ottima, florida salute.

¹ ms: verdeggianti.

² fia = sarà.

³ brevo. Forma desueta per breve.

Vetëte

Neomen'ja	<i>kopile arbëreshe</i>
Axhezllau	<i>trim që përdoj Neomen'jen</i>
Ifixhen'ja	<i>shoke e Neomen'jes</i>
Ermollau	<i>mik e pra armik ziluz i Axhezllaut</i>
Trezja	<i>mbashorja e Axhezllaut</i>
Morina	<i>vashë që përdoj Ermollain</i>
Bozdari	<i>trim që përdoj Morinen</i>
Bollizllau e Lladhizllau	<i>vullezurë [të] Neomen'jes</i>
Llōmedhondi e Elena	<i>prind të Neomen'jes</i>

PARFJASJORI

Një mallë i rī më shtiti të këndonja
ndë vjershe jo llautimi moj të qari
gjellën e zez di trimave ç' i nxori
vëdekja njize njize ka kī dhë
sikur të kishë pas vidhje e rronī, 5
se duhëshin më se jëm do një bilë
me amurë mëllagsōrë. Kurë kishin bes
se fata ruaj fanmirë tirin amurë
e më i losej zëmra nd' at zjarr,
illi ju verdhua e drita i iku, 10
mixirë i keqë arrū te shpia saj
e rrëmaksëme ja la pa mosnjerī,
se pjaku tat e jëma van përpara
me di sajët vullezërë tek gjella
ka s' priret më këtu njeriu që vate 15
e pra mizurë ajo me trimin prapa
i mbajti prindve [k]u ng' i lë prë mot.
O vashë e sfanmirë, ndë vjershi im
mundij të bë t' rroj ndunata jote
prë vite shum ndë dhë, s' e ndikuroj 20
shërbi'n që kesh t' bëj prë tij, kopile.
Moj penda ime ng' është e ndrequrë nd' aqë
e bën sa mund bënë, pra të lëshon
ku nëng mundën më e atje qëndron.

Atë i parë

Kuori

Amuri çë ndë vamb e zez më hërë 25
zëmrën prori njerzve e pra i lëshoi
ndë një udh të lig e gjërë,
nga një pra e dërgoi te jetri keq
njera çë s' pān çë bën e mbjatu sītë
me sqep të ngusht atirve ja mbuloi; 30
kī bën e hjidhītë
pandehji dheu e sa kī zjarr mbëshon
bën e njohu njeriu
kurë ndë spande u gjënd e mëngu sīn
e hapi s[a] atë ghuanjun oreksjoj 35
ç' i xheshur me një akullë i vet ndë dōrë
qeperiset vëlomon;
pjeqë, kopile e trima nëng lë,
e atij të ligu gjë njerī ng' i bën
o allmëngu e trëmbson. 40
Jo, se vikërrë duket e fuqī
kā më ai ghanjun se gjith dheu,
se një çë qe ndë gjellë vëlomën s' pati
me kë amuri nëng e theri, e thati?

Atë i parë

Shen e parë

Axhezllai edh Ermollai

Axh Pather ti, Ermollā, ai kuj thashë 45
qeve shërbiset thella zëmrjes mī.
Dunga çë kā ti di thanarja e gjiut.
Nani të thom shërbes çë ng' e pandehjje
o ndiajte ndonjë mot prë sa dhurove
pra ç'u leve ndë këtë dhë. Dje 50
lodhurë ka jushtrimi çë një turk
bëri prë një cop mua te detria,
u prortishë pra më siprë e ndën një lisi
kalithurin pushova e kalin lidha
ndë talë meje e sa gjumi m'arvoi 55
ëndërra se tata duaj të më martoj
e fjalëtë çë m' thoj ishin këto:

«Birë, nd'arvon ambnia e tas jushtritë
shtrëngonen tej mb' an madhit det,
martone e merr prë nuse një kopile, 60
si tij pëllqen, e bukurë e ghavnare.
Mori pëllqeu mua, e s' ke t' e keshë
prë lart hjidhë ti, bërë, se u të zgjodha
Neomen'jen prë shoqe» Moj kurë thonja:
«Bëj si do ti, tat», ndonjë xhatarë 65
shkrehu prë nd'ato sheshe e më pataksi.
Prora sitë e pë një kacamite
me katrë brī ndë ballë, ne mund t' arvonja
kurë ika prapa asaj, se me një ikton
vate lumit atej, e u qëndrova. 70
Vemi nani te pila, se mund jëtë
t' e gjënjëmi na pameta. 72a
Erm Jam përpara. 72b
Shkrepin mora, ani shpatën rrëmbenjë
e vjerre ndë kalithurë. Vemi pra
ku do ti, zot, se u prapa të mbanjë, 75
qot prë llaka o prë male, se m' kē
pather mik me tij, njera vëdes.

Shen II

Morina, Ifixhen'ja e Neomen'ja

Mor Ku ven këta jushtrorë të rënda me armrī?
Thomse ka mali kallaren pra ndë llak
çë më proposhë shtie udhën nga detria, 80
ka neve zeza pather turku vjen
i lig të na helëmonjë? 82a
If Popo, ng' i njeh? 82b
Gjitontë e tū jan këta: kī Axhezllau
edh Ermollai ë jetri ç' është prapa
e vete bashk me të. 85a
Neom Majdhe, çë trim! 85b
Lum ajo jëm ç' e puolli! Qeperise
së pë u më si kī çë bën e dheu
gjëmon ndën këmbve kurë vete me dirë,
i bukurë pōr si nj' illë nga qielli but.
Mor O Neomen'je, nd'e ndianje kur fjet! Bënet 90
si mōll i kuqë e ëmbëla si mjali

jan fjalët që thot. Me sī pëstaj
 më se kallamit zëmrat e njerzve
 rrëmben e u e gjegja
 një mot e më ç' ahiara nëng shoh 95
 mirë prë sa dhurova ndë këtë jët.
Neom Jetri bënëjemi fjalë, se ndë dritsove
 rrī zonja mëm e pret kurë u t' arvonjë.
 Gjegjën ndonjë fjalë e pra më thot:
 "Ti jë kopile e thuam ç' i do këta 100
 rrëfiame pak të mira". Ç' i përgjegje
 një ëmje që thot kështu? Buzën mbullin.
If Vërtet nge s' kemi na që jemi vasha
 të thomi ndë të bukurë o të ligjë
 jan trimat e katundit. Na kopile 105
 jemi e kë t' rrimi si një fōnd
 që një këmbat njeriu njinja njinja
 ujet ja thturbullon e pra ng' i pī
 huaji ç' atena shkon.

Shën III

Axhezllai edh Ermollai

Axh Ermollā, po ruaj, ndë të pëllqen. 110
 Një vetme kollponë, që gjegje, hollqa
 e vrara këtë delëpre që ti sheh.
 E kacamiten pë, që do t' gjënja,
 se erdhi nga llakata ku ti ishënje.
 Vrave ti, Ermollā, ndonjë shpirtogjellë? 115
Erm Eca prë nd' ato llaka e faregjë
 më shkoi përpara sī të nund i shkrehnja.
 Vetëme një llumbardhe bardh si bōrë
 më qelli dhun prë mot e s' mund t' e arvonja.
 E vej tue shkarartërë lis prë lis 120
 njera që bën e hira te ca ferra
 e duartë atje gërvishta e mëngu i shkrehja.
 U prora prapa ahiara, pjot rronī,
 te rahji e vrava atje një gurgullī.
Axh Vemi nani ndë katund, sa ata që bëm 125
 sosën, të s' mund na thon se faregjë
 bëtim ndë këtë pilë miri një dit.
Erm Bëj si do t' bëçë, zot' im. T' e thashë

se pather prapa mbanjë u këmbve tū.
Axh Ti ruojte, Ermollā, kurë shkuaam këtej 130
 kushë ishë te tjera udh nd' ato kopile
 çë pam, se Neomen'ja një m' u ndot?
Erm Vërtet, se i pë të trī: Neomen'ja njera,
 jetra ishë Ifixhen'ja e pra Morina
 e treta vij e fjit me ato të dia. 135
Axh Kjo qe kacamitja çë t' thashë
 se ëndërra ndë gjum e nani pë
 e zëmrën pa harë m' e la ndë gji.

Shen IV
Axhezllau e Trezja

Axh Majdhe, Trezje. Një dit me Ermollān
 haraksa u nga mali e ndë mest udh 140
 Neomen'ja m' u përpoqë, zëmrën vodhi
 nga stomachji e m' e suoll tek i pëllqeu.
 Nga vreshta prirej bashk me Ifixhen'jen
 e sillij ndën sjetull një panare
 e pjot me verdh durak. Pa skemandilë 145
 kësheti bardh shkëllqej si mali kurë
 është i mbuluarë me bōrë e ku menatet
 kundrela dielli delë e vete rrëmbi.
 Më ruojti m' ata sī të zeza shum
 e duk se ne më tha: "Ti ngë m' përdo? 150
 Ligu vjen mbi tij, se arvon një mot
 çë ti ture shërtuarë më dishëron
 e me noerë m' arvon, moj jo me duarë".
 Ngë kam ç' ahiara ambnī
 ndë zëmrë të m' jip një pik harë 155
 o allmëngu e saja hjë të më levroj.
Trezja O zot fanmirë, më ndjet se u t' e thashë
 se vret me ato sī, moj nëng shëron
 ajo, pse fare do trima të ruonjë,
 e sa ndë faqe zjarr buthton, ndë zëmrë 160
 aqë brim mban, sa mëngu njeh
 fuqin lartit amurë, çë si vëdekje
 gjithve stomachjin nget e pa vëlom
 kësaj ja la të vras shpirtin e tjerve.
Axh S' kam bes u thënin tënd, se s' mund jëtë. 165

Ajo, me sī çë priarë, një hërë dheu
bën e çelet e vëdes prë namurī.
Shpirtin nga trūtë trimave rrëmben
e duket se harën shtrëngon ndë dorë
amurit e ti thua se thtohte ë si bōrë. 170

Trezja Sot m' arrū ndë krie. Ajo mua taksi
se vemi ndë këto dit te petku i saj.
Ahiara nd' ajërë e shtie një fjalë e mīrë
prë tij e shoh si vasha më t' e marr.

Shën V

Bozdari e Morina

Mor Cila fat rron'juze shum 175
kët noerë nd' oreks vumë,
pra m' pataksi e qe s'vërtet?

E qëndrova vet vet
si një turtulle çë zbori
shokun e m' e zū helëmorī 180

sa t' qanjë jo pak mot
nd' ata llaka ku ng' i thot
mosnjerī: "Via, u llevro!" .

Kī këshillë ç' ani m' arrū
pather rrim si qen ndë trū 185
çë m' i bjuan e ngë m' lë

o më thot fanmiri gjë.
Mirë më lidhi e më shtrëngoi
e pra lidhure harroi

si një armike. Pa lipsī 190
bën e shkonjë me hjidhī
kët gjellë të zeze ashtu.

Qe ai ghavnari trim,
çë ka zëmrën si brim, 195
çë m' e nxori nga stomahji

kurë e pë çë shkreh te rahji
një llumbardhje çë vrau
por sa pjuhurit e ngau.

Ngau më pak atë se mua,
se asaj zëmra u bōrsua 200
e mua mjeres djeg edhe.

Bozdari Njoha se ndë këtë dhë ng' ë bukuria,
 moj vetëm një fuqī çë gjindën siall
 të don më mirë një pjak se një kopile.
 Një vashëzë ghavnare mua rrëmbeu 205
 këshillet gjith kurë parën hërë e pë.
 Nani më rrī si rē e s' mund më shoh
 e u pather për të qanjë e shërtonjë.
 Jetrë ngë dishëronjë se sajin gjī
 e këshetin t' i ngas fōrmadh e bardh 210
 çë pati aqë fuqī të nga stomahji
 trashkoj të boçëkun gardh çë zëmrën ruaj,
 me rrëmbat vëlomoj sajave sī
 e pra të më mērihej njize njize.
 O, dju ndë më kishë ardh një kopanē 215
 shkrepī ndë zëmrë u fare ng' e ndianja!
 Jo si ajo bŭz ghavnare çë nga pik
 "Ea!" më thot, pra "Ik!" e me një shpat
 kurmin pather m' e shkon e bën të that.

U sos ati i parë

Atë i ditë

Shën e parë

Kuori

Kurë rrij me ulëkun bashk 220
 shtjerri, kaciqi e dhia,
 u thom se namuria
 ngë njihej mirë ndë dhë.
 O thomse ndë një kopile
 përdoj një trim i lart, 225
 atë ng' i ndihej thart
 t' e duaj, prëdashe edhe.
 Moj qe kī thomse gjum,
 se pather ndë këtë dhë
 qe lip, hjidhī e harē, 230
 si e kā nani kush do.

Një qan e një këndon,
kushë lutën e kushë këxen,
një qeshën e një haren
e kā e ng' e përdo. 235

Morina, Neomen'ja, Ifixhen'ja e Trezja

If Morine, ea shih këtë rëdhī
si ē ngarkuarë e verdha rrushet kā.
Bekuarë zoti ç' e bëri kështu but
tjoren çë na mban. Siso atë fik
se duk' e do t' bjërë prë ngarkosinë 240
karposve çë kā mbalë. Ruaj atë dardh,
mollat bardha e kuqe. Këto ullinje
si leshi Axhezllaut jan të zeza e sitë
të formadhes Neomen'je. 244a
Neom Popo, ndrikull, 244b
mos thuaj më këta fjalë, se sitë e mia 245
i pë se jan të liga u, një dit
ç' i ruojta mirë mirë ndë një qelëq.
Ndë thom se mesi it bën e shërton
onjë ç' e sheh nga trimat e katundit,
vërtetën thom, se e kē dredhurë e hollë 250
si një purtek mundashi e se bumbaku
thomse më njom e kē. Vidhje ngë kam
se tiorja me tij aqë e bëgat
u buthtua e të bëri ashtu fōrmadhe.
Mor Vërtetën, Neomen'ja, u thom: të dia 255
bukura jini, por sa më këshilli
ghavnari mund pandehjinjë. Ifixhen'ja
kā buzën si një mollë e faqen kuqe
si qumbshti ē me gjak. Moj ti, Neomen'je,
aqë fōrmadhe jē, more thjesore, 260
çë duke por si hëna mbrënda nd' ille...
Trezja Mëngu t' e thonje dite. U ndë mest
do t' jem bashka të dive, ndë prë bukura
o prë liga ju mban kjo jona jëtë.
Sitë e zeza, leshet ari, qafën e bardh, 265

bālltë e hōllë e kini bashk, e faqja koillorme mua ndjet se s' k̄a jushtrī. Moj u ndiajta me veshë se një trim çë thomse e dini	
llautoi Neomen'jen shum e këto fjalë mbjatu mbanjë mend se nxori ai ka gola: "Thjesore vashë çë pather si një lule çë më ndë diell rrī [e] më hajdhonet. Lahet me vez menatet, kurë zgjonet, e fjetat gjelëbullore	270 275
nga një mbahen te jetra dit, pa thajturë fare, e si dhezura linare më haraksen kurë është më errëte nata. Pather me sī të but të ruat fata.	 280
Ndë ti tjerat kopile m' i mbulon si dialli tjerat ille mjezdit, mos shkot prë mua kī vit e të paça me kez verdhe si ari, me coh të koillorme s[i] është bari, tue luarë formadhin sī, me mua të vishë mushk me mushk ndë qishë".	 285 287a
<i>Neom</i> Trezje, thē	287b
sa më deshe prë tij, moj u ngë dua të gjegjinjë këto fjalë. Ani këtu të lë e vete dalë.	 290

Shën II

Neomen'ja e Ifixhen'ja

<i>Neom</i> Ifixhen'je, zëmrë s' kam e nëng dī t' e thom u kushë m' e vodhi. Një hajdhī e një spjaxhirë më rrin pather ndë trū. Njeri më thot «Çë bën?», jetri «Çë lë!» e kështu mbanjin prë mot mua ndë jushtrī.	 295
Jo njeri o jetri mua ndjet se vinxhon. Si di armiqë çë jan të fuqiruz pather një shortje rrin, kështu ndë zëmrë amuri e ndera bën. I pari thot: "Ruaj çë trim të do, me bukurī ngarkuarë sa më me sī ti nëng e pē.	 300

Si shpata nd' atë kalithurë i kâ hjë!
 Shëndoshë si qeperis, ai prë tij
 vëdes e ti ng' e mban nd' oreks fare?
 Stomahjin kē si hekurë ngurt o gurë! 305
 Të merr ai prë shoqe e ti nderuame
 llautone ndë kopile, se një trim
 më mirin nga katundi dhëndërr zgjodhe".
 Nderja pëstaj thërret: "Çë bën, kopile?
 Nga prind leve të lart e rriturë qeve 310
 hajdhjare e nderme kaqë sa s' mund e thom,
 e nani këtë vëlom sat ëmi bën,
 të farmkosurë des? E tët vullëzërë
 nd' e xën, çë bën ti më nga gjella jote?
 Le, kopile, le këtë noerë! Për tij 315
 i mīrë nëng është kī. Atë çë thot
 jot ëm e zoti tat ti ke t' bëçë,
 e jo si thot amuri, çë të siall
 pather te udha shtrëmbërë. Ti mos ec
 atej, se bie ndomos te gropa stesjes". 320
 Nani, Ifixhen'je, thuam si ka t' bënë
 çë gjëndem ndë këtë rrënjë e ngatarrjarë.
If Zonja ime, edhe një mot u qeva
 me zjarr ndë zëmrë e qajta nat e dit
 njera çë shkoi një vit e pra u harrova, 325
 se vëdekja m' e mori
 atë çë zëmrën nga stomahji nxori.
 Ndë rroj, bënja më zī,
 se m' vritjin ato sī kur e prosteksnja.
 Nani u s' dī çë thom. Më mīrë qën 330
 ishë ndë m' e kishe thën të parën herë.
 Ti dī se tas jatria vëlomsë gjë
 miri ng' i bën, nd' e çon të bërë e keqe,
 se fëjiba ju rrit e vëdekörë.
Trezja Majdhe, Neomen'je. Ku ti gjënde, udha 335
 bën e shkëllqen e qielli, si ndë vrërtë
 shkepti bukuron llakata e male.
Neom Trezje, mirë se arrure. Ea tashë
 se shtimi ani një vjershë, çë nga katundi
 afërë e kundrela jemi e gjindja ndian. 340

Këndim I

Trim ghavnarë, buthtou ng' ajo dritsore
të ruonjë formadhin sī e leshet ari.
Siso sa bën prë tij nj' e zez mixore
çë bëri prë spjaxhirë faqen si bari
e ti një kred nga lipi nëng e nxore, 345
por bën e djeg si miçi te linari
pa valë e tas vëdekja verdhullore
qaset e më moti ikën i vrari.

Këndim II

Qasëm atë buz si roz para të des
e nj' ëmbël puthurë ëm të më shëronjë, 350
se u ndë këtë gjī të bëra pjes
e natën qanjë e ditën së t' harronjë.
Allmëngu qot kjo më madhja stes,
se tij u dishërova e të dishëronjë.
Të dishërova: e thashë e të jap bes, 355
e pather lutinjë tij njera çë rronjë.

Shen III

Axhezllai, Neomen'ja [e Trezja]

Axh Të pë, Neomen'je, tashë. Mos ik më,
moj ëm një pik levrom ndë kaqë lipime.
Thuam një fjalëz e but, faqen buthtom,
buthtom qafën të bardh e siun e zī. 360
Mos bëj si djali bën kurë sheh një hjë,
ç' i trëmburë shkapërdhiksën. Pritëm, via,
të fjas një pik me tij e nga se des.
Neomen'ja M' e shqore gjirin me të ruara e thëna.
Thuame, via, çë do. Zëmrën t' e dhë, 365
buthtou një mot kutjend e mos më jip
të zeza më hjidhī e mba nd' oreks
se besa çë të jap një puthurë është
kësaj llunaz ç' e vë te gjishti tū.
Rri fuqiruz e duam si dua u tij 370
mirë e mos u trëmb nga besa ime.

U gjegja shtrushë e vete.	372a
<i>Axh</i> O Trezje,	372b
u jam ndë një furnaxhë e pjot me zjarm.	
Qanjë prë nat e dit e ngë m' levron	
njeri të m' e rrasnjë këtë noerë	375
çë si një hjë e ulurë ndë stomachjë	
pather ndë sī më mban ballin e bardh	
e gjin të Neomen'jes. O thjesore	
vashë, çë bën e rrī ndë dit me nat,	
se dialli m' u perndua e më ngë vjen.	380
Kushë mund m' e thoj se tij prë shum mot	
me lot ndë sī kesh t' qanja e dishëronja?	
Të jen hajdhjare allmëngu këto lot	
një mot, kurë ti pushon te ila ime	
me larte ambnī çë s' mund rrëfihet.	385
O qiell i but, teshkro fjalet çë thom,	
e thartat lote çë më bëtin surkun	
ndë faqe mī meruarë e ndë shërtime	
të dhezura si zjarr u shtie nga gjiri,	
sillja ti, erë, ndë veshë vashes fōrmadhe!	390
Thuam ti dunga, Trezje. Vajte fole	
me sprënxën tek u gjella ime rron?	
<i>Trezja</i> O zot, se ti më shpon me këto thëna!	
E gjith të miat bëna faregjë	
bënjin pr' atë çë ndian e dishëron.	395
Vam te petku i saj e dalë e dalë	
një fjalë ndë veshë ja shtura, se ti des	
aqë ka miri ç' i do e ajo rrī ngurte.	
Moj vasha, bërë e kuqe, u mērī.	
Moj njoha u ndë sī se të përdo,	400
se nën e nën i kishë ngarkuara lot	
e më u s' dī të thom nga zëmra saj.	

Sosëmi

Shën IV

Bollizllai, Lladhizllai e Neomen'ja

Boll Motrë, një pjaxhirë të vemi bashk
ka tonat ara, te Vojanin kemi,

me tij e Ladhizllaun mua më shtin. 405
 Ashtu ti, motrë, sheh si sheshet jan
 me bare gjellbullore e lulëzuame
 ka dritsorja e na vemi te pila
 e vrasmi ndonjë katrëmb. Rrango te tata
 e zonja mëm e thuaji se menat 410
 me grā tëharrëmi grurtë e vemi sod
 të gjëndemi njinje na te Vojani.
Lladh Vullā, xa shkrepin, se t' e solla. Shpatën
 nani vete t' e marr nga jetra sällë.
 Brezin e kuqë të siall o ërgjënduamin? 415
 E shabjen arësuame me pendoqë?
Boll Sillëm cilin do. Neomen'jes thuaj
 të vishet mbë gjims, jo hajdhjare;
 të marr uratën e pra të vinjë, se vemi.
Neom Vullezërë, zoti tat e mëma edhe 420
 uratën ju dërgon e than të vemi
 me ambnīn çë na dërgon Thjeu.
Lladh Xhatari u vesha u e tij të solla
 brezin xhatari edhe e shabjen bardhe.
 Kuelet jan të trī përpara dërë, 425
 Neomen'ja pret edhe proposhë kurë vemi,
 Kriatet vun ndë duak atë çë domi.
 Pse mënonjëmi më e nëng nisemi?

Shen V

Ermollai e Axhezllai

[*Erm*] Axhezllā, çë kē? Ndë bällë të njoh
 se shpirti ngë të rrī mirë. Ti dī se miku 430
 kurë nj' etrë miku i thot spjaxhirët [ç'] kã
 i bënë më të leza spasitëtë.
 Rrëfiam dunga çë kē çë rrī helëmuarë
 e faqen siallë të lipme e skoillorme.
Axh O Ermollā, nd' e dinje! Keqe rë 435
 zëmrën më sëmbron çë somenat. Noeri
 duk se ne më prëthot se gjë të lig
 o sod o ndë këtë jav u ka t' dhuronjë.
 Tashë çë s' mund e nxiarë, via, vemi jasht
 ka mali ngaha vam jetrën dit se atje 440
 mund jëtë çë vrasmi na ndonjë shpirtogjellë

e thomse mua rrasonet kī kēshillē.
Erm O, zot, sa më spëllqen! Moj spasi-tëtë
fuqia ka t' i vinxhonjē. Levrou ndopak,
pandehjē tjera shërbise, se të shkon 445
noeri çë t' mban i luftuarē. Nani
vemi ka mali e shkrehmi na ndë shkak.
Axh O, vemi, se një shtrushë m' arrū ndë veshë
si uje shum çë bīen nga larti rahjē
o si milon çë bën pather një modhi. 450
Zëmëra më patakset ndë thanare
të stomachjit e shpirti i trëmbëm rrī,
kurmin gjith m' e mundi një thorporē
e lotet ven padashure ndë sī.
U s' njoh çë vjen me thën kjo hjidhī. 455
Erm Zot, ti jetrën dit pjonu harē mua
thonje se kishënje parē një kacamite
e nani helëmi t' arrū? Via, u harro
nga kī noerē i keqē e mirr armritē,
se vemi ku të duashë, prë sheshe o llaka. 460
Axh Vemi, Ermollā, vemi se vinjē, me gjith
se gjëndemi pa pjaxhirē, u prapa tij.
Jemi te mali tas: ti merr nga llaka,
se u nga çuka, e mbjidhem pra proposhë.

Atë i tretë

Shën e parë

Kuori

Ti, djalë ç' ike nga qielli e u kallarte 465
ndë truoll të bënje trimave jushtri,
vashave bukurī sa munde i dhē
e burrat i harrove,
si korrësori lē kalliu çë bie
e më ng' i shkon nga krie, moj pra një llojē 470
kallëzore i mbjedhënjin një prë një:
njera të madhën merr e jetra atë
ç' i vjen asaj përpara.
Kështu gjenden të ndara e vasha e trima,
e një kā natën e bardh, jetri e kā tharte; 475
një bukurī o gjak vete tue gjën,

nj' etrë namurīn bën, pse i pëllqen
 një kopile e m' e rrëmben, me gjith se gjir'
 e [th]tohtë e kā si brima. E ti dhuron
 këto shërbise, amurë, 480
 pa lot e pa dhëmbim,
 pa helëmë e pa trëmbim, e bën e qan
 i mjeri trim ç' e mban zjarmin ndë gjī,
 se ti ng' i vë jatrī allmëngu kurë
 lëftuari rrī të des. 485
 Ik, mos kī më pjes
 me nē, se ti na vret.
 Ndë qiell priru papā,
 se thomse zbjerr të kā
 jot ëm e rrī e të pret, 490
 se më me nē ngë kē këtu riçet.

Shën II

Çë m' vëlen kjo bukurī
 çë tjorja shum bëgat
 më shtëfrosi ndë këto faqe,
 sa t' mbulonja tjerat vasha? 495
 U ngë donja sītë ghavnare,
 se fuqī mua biznjoj
 sa t' çanja kët katin
 çë të lidhure më mban.
 O, vullezërë! Moj ku jan? 500
 Neomen'ja motra juaj
 si një qene lidhur' është
 mes e duarë ndë trashe ndin.
 Kushë t' e zgjidhinjë më i vjen
 trim i pjot me lipsī? 505
 O vullezërë, o Lladhizllā,
 si të veni ju pa motrë
 prëm te mëma e zoti tat?
 Çë mixirë i keqë t' arvonjë
 zonjësë mëm, kūrë t' e djerë: 510
 Neomen'ja është e zbjerr!
 O vullezërë, nëng mbjidhi,
 u e dī, te shpia prëm,

moj mua veni ture gjën
 nd' ato dushqe, ture qārë, 515
 ku ndë thirm ju rrispëndon
 eku, e vetëm e helëmorë:
 "Neomen'je, o motra jon,
 kushë e dī te cili vend
 më të suoll dhëmbi rron'juz 520
 ndonjë katrëmbi o dora keqe
 ndonjë turku çë të vodhi.
 O, të t' shihëjim e jushtrī
 nā se bëjim ndë këto male
 me armikun e të vej 525
 gjaku udhve si llavin
 o të disëjim të trī,
 se arvoj ahiarna nova
 te shtëpia, ç' e sillij era,
 jo vullzërit e tū 530
 çë të mizurë e tue qarë
 ndë pullas priren si bilë
 kuj vëdekja shum rron'juze
 ndë një dit nga dheu nxori
 jëmën e t' ān me një rrongat. 535
 Duket shpia si foloqī
 çë qe lën prë vitvit
 por ndë dirë e ndë rronī
 shiut e motit ji lig.
 Neomen'ja ng' ësht më, 540
 ngë përgjegjet o ju ndian,
 vetëm faqen bukurëz
 ja shtrëmboi trëmbima [ç'] mori
 kurë turku si lion
 e rrëmbeu e ngrah e vū, 545
 pra sarposi nga llakata
 ç' udhën shtie te mali madh,
 ku m' e lidhi fuqiruze
 ndë një thesollë errëtë e thëll,
 aqë çë dora ju bē zez. 550
 Sitë e saja çë shkëllqijin
 si shkrepitima nd' errëte nat
 jan të shujta ani e lodhëta
 aqë nga lotet çë shtun.

Thirma ëmbëlë ju bragharë prë ngaleset me qiallë, mishet saj bardha si bōrë jen të nxira e kondra bërë.	555
Me llunazat ç' ajo kishë bëri turku shum i lig një katin e ku ng' arvoi vū vanderën e terjorisurë; me t' koillormen xigharele ngatarreu të trashën ndin.	560
O vullezërë, kushë levrom ndë këtë lip mua mjere jep? Kurë t' i frinjë nova ndë veshë atij trimi çë m' përdo, cili gjëmb t' e helëmonjë ka t' arvonjë njinje njinje?	565
Moj çë qanjë tjerit trëmbim? Kam të timin vajtonjë ç' është i madh sa s' mund e thom. Ndera ime, çë një mot pjot me doks qe shërbesi	570
ku rā vidhja me rronī të kopileve e katundit, e ghuidhiren thesollea të një mali shum i zī.	575
Bukurin të dishëruame katundarve e huaja trima nani zbiarë e pjuhuronjë ndë këtë vend i thell e keqë.	580
O vëllezërë, o zoti tat, mosnjeri shërtimet mia gjegjën e lotet ç' ani shtie.	585

Shën III

Axhezllau, Neomen'ja e pra Ermollau

[A xh] Neomen'ja, cila fat këtu të solli? Cila zëmrë e ngurt di herë se guri nëng u çā kurë dorën tënde lidhi? Cili sī ngë qajti ture ndiaturë	590
--	-----

tëndin vajtim, bukurë kopile?
Cili shpirt i thtohtitë më se brima
nëng u dhez tue parë faqen fōrmadhe?
O qiall, çë bën e shoh! Dielli m' u err
e dita tas m' u nxī. Ku është armiku, 595
të shoh si shpata ime ndë kalithurë
i hīn e kuqe delë papā jasht
me prapa shpirtin tij? 598a
Neom O Axhezellā, 598b
nani vërteta njoh se fata do
të jeshë përdashur' im. Via, ndë m' do mirë, 600
zgjidh këto trëkuz çë mbanjin lidhurë
mesin e duart' e mia. 602a
Axh O turk pa bes, 602b
nd' amurin nëng ndian, ndiaj këtë shpat
si gjakun tënd lipin e si i pëllqen!
Neomen'je, ruaj si vjen 605
shpata çë hiri mbrënda,
siso si t' i paguan trëmbimtë e rënda.
Neom O Axhezellā, ka u çë do bëj. Kopile jam.
Ndë gjī pather të pata e më të kam.
Nani çë më librarte kët hjidhī 610
të mbanjë pather ndë sī.
Erm Zot, çë pate? Faqen e solle verdhe
si një kurë është i trëmburë nga një hjë
çë shpirtin ja tramaksi ndë një thëllë
malë o pa vëdekjen me sī, 615
se ndonjë katrëmb i madh ju bë përpara
tue llastimisurë dhëmbtë. Thuam: çë pate?
Axh Vemi se xhatën e bëm.
Hajdhī pata e spjaxhirë
e shpirtin pjot me dirë. 620
Erm O zot, mos bëj të rrī më nd' errëtë nat.
Thuame këtë fat çë të helëmoi,
se shpirtin mua sëmbroi edhe spjaxhiri.
Ashtu të rruat më miri çë ti do.
Axhezellai Vemi nani, se pra kurë është mot 625
të thom hjidhìn çë pata me hajdhīn.

Shën IV
Bollizllai, Lladhizllai

[Boll] Popo, vullā. Neomen'jen ng' e prosteksinjë.
Zëmra m' e thot: qe vjedhurë motra jon!
Popo, ç' i thomi tatsë kurë të vemi
ndë shpī pa Neomen'jen? Sa na des! 630
Njinje nga mali japmi e ndonjë vend
ngë lëmi se t' e shohmi por me sī.
O na zbjidhemi të trī o Neomen'jen
te mëma ke t' siallmi. Ndomos bushtra
vat të siell ndë shpī ndonatën e keqe 635
se na qëndruam ndë malë e motra u zbruarë.
Lladh Ajlimono, çë gjeta?
Vanderën e times motrë kam përpara?
Thomse siu më bën e ng' ë vërtet. E njoh,
njoh terjorisin e saj çë pather bëj 640
ndë keza e ndë vandërë. O motrë, o motrë,
vëdekure tas gjakun jë, e njoh. Kurmin
allmëngu do t' gjënja edhe pa shpirt,
të binja siprë i vrarë nga dora ime.
Motrë, ike e mua lë ndë hjidhime! 645
Popo, një turk është kī dekurë ndë truoll?
O Thje, çë shoh!... gjëndet me gjak i pjot.
Kī vodhi Neomen'jen nga Vojani
[e] e suall ndë thesollë të këtij mali.
Ka gjeturë thomse gjind e ja rrëmbian; 650
ai s' do t' e lëj - e vran. O, Neomen'je,
llunaza si katin gjeta te ndina.
I pë e tëndet ishin: ishë e arta
çë zonja mëm të dha, edhe ërgjënda
me gurë çë të dha tata. Moj çë kërkonjë 655
mot të më dhuronjë? Neomen'ja diqë,
gjakun kuqë e njoha, singat i gjeta,
xigharelen e shqerr. Ngë mundinjë më,
Neomen'je, të rronjë. Me tij u vëdes,
o motrë, e gjellën e pres me këtë thik! 660

Shën V
Morina [e Bozdari]

Mor M' u fanaros si bardhe rē ndë sī
e trimit thika çë zëmren më shkon,
atij çë pather vret e vëlonom
me tijen bukurī.
O vëdekje, 665
sa jē keqe!
Më shtrëmbon
e më hajdhon,
bën e qeshinjë,
bën e ngjeshinjë 670
por me lot faqen ndë gjum
si një zallë ndë një madh lum.
E prosteksa, u ndënda, e pē,
pra thërrita: O, fodhonē!
Zjarmin çë kam ndë gjī si friti e iku. 675
Piqemi si ndë furnaxhë një qaramidhe,
më mori si një zog ndën një paidhe
i zëmrrjes time armiku.
O pjaxhirë
jo shum i mirë! 680
Popo, gjëllë,
sa jē e thëllë,
pjot furbrī
si një rëdhī
m' ata rrushë çë verdh buthton 685
golën mjerit ja tharton,
ç' i pëllqen e vete e [e] bën
e pra një etrë shortje [e] gjën.
Boz Llakat shurdhonjë me timet tharta qara,
e me shërtimet [ç'] dalën nga mushkria 690
nën meje ajërin dhezinjë.
Bëra si bën rëdhia çë qe e prërë
ndë dimrë e lot dërsin ndë paravërë,
se lotet time rara tas një krua
rritin si një përrua çë rrī e vajton 695
poshtaz ka cado llaka ku dirarme
gjën formadhen vashë e ng' i purton
se këmbën i puthën e tue qarë e çon.

Ndë qajta njer nani, nani këndonjë
e, mos qajturi arrū, u bë t' i arvonjë 700
te veshi një këndim
t' e zgjonjë kopilen e t' e ngrohinjë mirë,
nd' e gjën bëre si brim.

Vjershë [I]

Vashë ghavnare e kuqullore,
këta keqe shtepasī, 705
via, të piershin ndë lipsī
të m' thuashë: "Tas u levro!".

Vashë çë zëmrën m' e more,
ndëjme, via, të bardhën dōrë,
shtrëngo timen çë m' u shqōrë 710
nd' ato ferra e më shëro.

Vjershë [II]

Ti, si nata është pa hënëz,
bën e jan gjumet e mia.
O Morine, ti hajdhia
jē të zëmrës çë t' do. 715

Gjegje, via, timen thënëz
të më duashë një pik mirë.
Bëme, via, këtë pjaxhirë,
bëjme njize e mos mëno.

Sosëmi

Atë i katrëmë

Shën e parë

Kuori

E virgjëra roz, më parë të hapet gjith, 720
me buz të kuqe trimin e thërret,
kopilen mbjatu e pret

kurë shkon t' e shoh, se era, kroi e trolli
 e lutënjin por me drit e m' errësi
 e mbanjin sitë atje prë motmot. 725
 Ahiara zëmra i thot : «Ndëj dorën e mirre!».
 Rrī vasha ndë këshillë,
 pse trëmbet, se ndën fingillë gjëndet zjarri.
 Ndën dorën e papā
 e priarë, se trëmbet prapa. 730
 E roza rrī formadhe,
 mallin së ndikuron çë vasha kā,
 e mbrënda ndë murriza
 ghavnare ja buthton
 fjetat e buzën kuqe. 735
 Vasha ngë mundën më
 [t'] dhuronjë e dorën ndën,
 moj pra gjëmbat gjën e ja gërvishtënjin
 e sprënxa i thot se jasht e nxiarë
 të bukurë e dhuruze. 740
 Një ferr i pjot me dirë, pse ja vjedhë,
 ngalloset e ja shqiarë,
 e gjith shërbinë çë bëri
 ndë një tramot e zbiarë.

Shën II
Ifixhen'ja e Trezja

[If] Trezje, ndëjm veshë, se të rrëfianjë 745
 nj' ëndërrë [çë] pata sonde ndë mjeznat.
 Skotisa shtratin kurë u ndiajta e zëmra
 më gjëmoi si kurë ndë malë gjëmbi
 ng' ajëri bie ndë truoll. Më nditej, Trezje,
 se venja ndë një llak pather proposhë 750
 e më thellonej sa më venja u ndën.
 Ruonja udhën e këmbtë sa t' mos binja,
 sa një shkëllqierë haraksi nd' udh si nj' illë.
 U hjodhëtishë t' e rrëmbenja e një llunaz
 m' erdhi ndë duarë s' ajo çë Neomen'ja 755
 sillij te gjishti mesëm, sa një pjak
 sisova çë nga u vij ture qarë
 me sī të kuqë e faqen si kamnea,
 me bardha dhëmb e me bragharme thirm,

me një vjetër e shtrushëme coh si një këmbōrë. 760
 Leshet m' u ngren e zëmra m' u tramaks.
 «O vashë!» më thoj e mua trandaksima
 faqen të verdh ki' m' bërë si një vëdekuri
 çë jo para o dita frev te jetri dhë
 e kumbisi. Më muari ajo prë dōrë 765
 e m' sillij ture thën: "Mba, vashë, nd' oreks
 se dje turku u kallarë ndë këta vende
 e vodhi një kopile. Një jushtrōrë
 e pā nga katund' it e pra ja mori
 e një nga turqit vrau. Kurmin shih, 770
 sa nani t' e buthtonjë". Ahiarna thashë:
 "O mëm, nd' ashtu mund të thërres, thuajme
 kushë qe kjo kopile çë ngallosi
 ndë dorë të turkrive". "O vashë, nd' e dinje,
 spjaxhiri shum t' e dridhij zëmrën! 775
 Mund jëtë ç' e njuh ndë singa ç' atje gjën".
 Ndë një thesollë më solli, ku një ndin
 ishë me një katin bërë me llunaza.
 Ca gjak sisova e pra një kurm ndë truoll
 i shtun s' arvurë i prerë. Pjaka njinje 780
 më la te vendi e iku. Ahiarna gjumit
 u spataksa e ndë shtrat e lagtë u gjeta
 me lot e me hjidhī. 783a
Trez Popo, Ifixhen'je, 783b
 vërtet se gjumi kā shum thamasī!
 Çë vjen me thën u s' dī t' e thom, se nj' etrë 785
 cop ç' e oreksjonjë vëhem' e qanjë.

Shën III

Ermollai [e Ifixhen'ja]

[Erm] Dunga nj' armik prë mot pata ndë krah?
 Axhezllau kopilen duaj çë mua rrëmbeu
 e taksurë qe m' prë nuse? U nëng e dinja,
 ndomos te jetri dhë, më pārë se kī 790
 mot prë të arvoj dërguarë e kishënja.
 Zë bes nani përpara dheut e qiellë
 se Neomen'ja pjak, nuse e kopile
 pather te ila ime ke t' rrjërë
 prë gjith motin çë rron, ne më m' e nxiarë 795

njeri këtë noerë nga trutë e mia.
Axhezllaut mushia, moj, ke t' i pjaset
me një shkrepas ndë zemrë që ja hollqën
kjo dora e mi diruze e bën të shoh
sa Neomen'ja rri e sa i vëlen 800
fanmiri saji si. Mikun më bëj
e rrij si drangolë te stomahj' im.
Ka t' bë t' qëndronjë si brim i tiji, e gjak
të shtjerë i nguqet kurmi e pra i thom:
"Armik, e meritove. 805
Prë këtë nani dekurë qëndrove!"
If Popo, mixirë i keqë! Neomen'ja
dje mbrëma me vullzërit nëng u mbjodh.
I pjaku jat e jëma jan mbë lip
e s' dën që të pandehnjin. Ermollā,
810
mua zemra m' e parthot se ndonjë të lige
gjetin spasi të afëri malë.
Erm Ifixhen'je, që thua? Ng' u mbjodh Neomen'ja?
O, gjëllë e zbjerr ! O, fodhonë ! Ku vete
të gjënjë Neomen'jen më. O sprënxa ime,
815
nga duartë shkapërdhikse njëzë njëzë
e si kurë dielli më lë përndon e lë
si spovisërë fingjillë meruamin dhë.
O dirë, o vëdekje, o hje!
Neomen'je, më ku jë?
820
If O amurë, sa kë fuqi, që zemrën
njerzëve ja shpon e prë jatrë
strepë i vë e dhëmbim. Allmëngu një
t' arvoj tij gjith nga dheu sa ti spëllqen,
825
që zemrat mbjon vëlom e ng' i shëron,
moj më me keqë tharton, e mjër' e zë
ai që nd' ata duarë liga ngallosën,
se mban ndë krah di armiqë pa lipsi:
ndë prëhërë amurin kã,
830
zilisën e mban ndë gjë.

Shën IV
Bollizlai

O bushtrë, jë ndëndurë se një vullã
e një motrë më solle nd' atë vend, ku më

ajurë ngë shohen e diall, ndë një kred?
 O bushtrë e keqe, u ndënde
 se nxite illin bardh çë na shkëllqej, 835
 se preve qeperisin çë lulëzoj,
 se truollin bën e pā dhafna hjesore,
 se lisi bën e rā i gjellbullōrë,
 se tharte të dhuruzen monosaqe?
 O fat jo fanmīrë, moj pathër keqe, 840
 sosu, se shpīn gramise çë një mot
 nditej se me sī të but e ruonje.
 O vullā, ku të gjënjë? I kuqë jē bërë
 me gjakun çë të duolli nga stomahji,
 pa fjalë e koillorë ndë bardhe faqe. 845
 Sosemi të t' shoh. Neomen'jen fare
 mund e sisonjë prë ndë këto vende.
 O motrë, ng' është kjo vandra jote ?
 Ng' është llunaza çë sillij bardha dōrë,
 dora çë ndë bardhī avollin shkoj 850
 e qumbshtin e mbuloj prë bukurīn?
 O motrë, o vullā, të bjerrafat, çë fīn
 i lig juve thirri ndë këto male!
 Kurë mëma e zoti tat nga gola ime
 ndienjin këtë ndonat, çë zëmra i bën? 855
 Trëmbima i vret ne më Neomen'ja i gjën.

Lutëm, malë, e mos më jip
 mua fuqī t' arvonjë te tata
 i meruarë, moj ti ndunata
 bën t' arvonjë me ērë, e zez. 860

Prirëm, o Zot, ndë kē lipsī,
 ndë një gurë o ndë një krua,
 të vajtonjë u si përrua
 këtë hjidhī rēnde, jo lez.

Shën V
Lena e Llōmedhondi

Len Popo, bilë! Dielli perndoi 865
 e ndë shpī edhe ngë ju shoh.
 Vendin tëj u mëngu njoh
 ku ju suall këmba tutje.

S' kam ku vete të kërkonjë,
se ani drita m'u zezua. 870
O Neomen'je, sitë e tua
ng' e dritsonjin më njinje.

Si ndë dēt një tembestat
zë një voglë e vjetre anī,
erdhi mua larte hjidhī 875
çë te gropa më dërgon.

Kurë ndë mbrëma rrī te vatra,
ruonjë nga një te jetr' ān
bilëtë e mia, moj nëng jān,
më Neomen'ja ngë m' hajdhon. 880

Llōm Ajlimono, ndë zëmrë
një lëmbshë i trashë m' u bē.
O bilë, ngë shihni më
ju tatën, se ju des.

Uratën u ju e dërgonjë 885
ndë jini allmëngu gjällë.
O bilë, se si kriställë
ju mbajta e së kam stes.

Pandehja, e qe s'vërtet,
se ndë time pjakërī 890
di trima pjot fuqī
mua fata kesh t' m' i ruaj.

Ma çë! Se ajo diruze
më parë se moti i mori,
të trī nga dheu i nxori 895
ndë një dit, jo jav o muaj.

Neomen'ja çë llumbardhe
dukej ndë qeperise,
vëdekje, m' e kumbise
ku tij pëllqen tutje. 900

Kushë njuh? Katrëmb i zī
m' e shqori Lladhizllānē,
pa shpirt la Bollizllānē
o sod o thomse dje.

Vëdekje, mua më lē? 905
Mirrēm edhe me ta.
Çë bënë ndë gjëllë pa hjë,
se fata nëng m' e dha ?

Më la hjidhī e spjakhīrē.
"Harëtē" më tha, "ç' i do?". 910
Më lā pa mosnjë birë
e "Shum" mua tha pra "rro!".

Atë i pesëm

Shën e parë

Kuori

Lehet njeriu ndë shtrat lart e ghavnarë,
i mbajtur si jatria ndë një kristallë.
Bihet ndë tup një lule, 915
prë nd' an e ngatarrja[r]me me murriza
e ndën me keqe driza, moj dhuron
ajo më se njeriu, bardhe fōrmadhe
ndë gjëmbe e ndë hjidhī.

E mos dielli ng' e than o dora e merr, 920
faqen buthton pa shqerr prë motmot.
O vëdekja o amuri o hjidhima
o fodhonea o zilia

vrasën kopile e trima ndë këtë dhë
ne nj' ambnī u gjënd 925
por sa qe gjella gjate

me kë stomahji u ndënd mjerit njerī,
moj jo se pather thate
noeret ju buthtuan e duartë e lara
me lip, me lot e dirë, 930

me gjakun prindve, me vidhje e rronī!
O jët, si na ngallosën nd' atë rrënjë
e më ngë na lëshon

e kurë një keqë fjë
ti jetrin vete zgjon. 935

Shën II

Bollizllai[, Llōmedhondi e Lena]

[Boll] O shpit e mia të zeza! O dritsōrë
të pjota me lip si errëta nat!
Ndëlemni, mëm e tat, se nov ju siall
të gjīn ju rronizonjë,
se pra ç' e thom ngë rronjë u nga spjaxhiri, 940
se tas më miri mua

m' u pjas nga sītë, çë donja.
Vam ku fata duaj dje kurë t' e tham
e motrën tën e lam te sheshi madh
ku na Vojanin kemi e tue xhatarturë 945

vam te pila pra lumit mb' at an
çë shtie nga deti e kur u prortim prapa
u ruonja ndë Vojan të mund sisonja
Neomen'jen ndë dritsore, moj ng' e pē.
Ndiajti ahiarna zëmra një kopanē. 950

Thirra vullaun e vam njize e ng' e gje'm.
O tat, çë bumbullim ndë gjī m' arrū
e keqe shkeptim ndë sī haraksi!
Qajta, fishklleva e thirra e ng' u përgjegjë.
Çë ngë bëm, çë nëng thām 955

prë nd' ato pila e male, u nga nj' an
e Lladhizllau nga nj' etrë e gjë ngë pām,
njera çë vullān nga sītë e zbora
o pra, si deshi hera, vate diq
te motrën thomse gjeti e ku pra solli 960
fata diruze mua. O tat, o mëm,

çë spand nani ju thom të ju shtrëmbonjë!
Ruojta e pē një vēdekurë. U afrësuashë,
e njoha vullān, me gjī të shqerr, bërë
i kuqë si një nerënx nga gjaku [ç'] doli. 965

I praptë rrij ndë truoll, me hapta sī
prjerra nga qielli, si të kūrë lutoj
ndihëmen e madhit Zot,
e thikën e gjaksuame edhe shtrëngo
me dorën e djathtë. Pra më tutje 970

sitë më van e një vandërë sisova,
 vajta t'ë njihnja mirë e nje llunaz
 m' erdhi ndë duarë. Neomen'jes terjorisin
 oreksa ndë vandërë e ishë e saja.
 Ture dredhurë e mora e ture qarë 975
 me shkrepin e vullaut, ku pra shkela
 një turk ndë truoll vëdekurë
 e më të thom u s' dī,
 o tat, nga kjo hjidhī.
Llōm O birë, via, ndëjm atë vandërë 980
 t' e shoh e llurtmen hërë, moj jo më ngrah
 Neomen'jes ghavnare.
 O bilë, u pjaku fare
 pandehja se ti, vashë, ishënje si shtjerri
 kurë është me ulëkun bashk prë nd' ato pila 985
 çë o sod o nesërë e hapën
 ai golën të zbramarme
 e mizurin e hā. O bila ime, uratën
 më lipë e u t' e dhë. O Neomen'je, më
 ti ndë këtë gjellë ngë jē! Vullau ku është? 990
 Vëdiq thomse për tij. U ju bekova
 e, ndë vëdekjen mallkova, qe se des
 bën e me madh spjaxhirë.
 O Lladhizllā, o bilë, lule sfanmirë!
Len Neomen'je, o Neomen'je, via, përgjegju! 995
 Jot ëm ë çë thërret. Moj ti ku jē?
 Llunaza më përgjegjet prë ndërë tënde,
 jo ti, kopile rënde
 me larte bukurī,
 çë bëne o balëtë o hī. It at 1000
 vate te jetri dhë prë lart spjaxhirë
 e dit' imi birë vëdekjen gjeti
 te vendi ku vanderën tënde pā.
 O bilë, o Lladhizllā, u ju mbanjë prapa,
 se nani m' arrū tas vëdekjes vapa. 1005
Boll Mizurë! Çë bënë u më ndë dhë? Iku
 hjea çë më hajdhoj. O mëma ime,
 drit çë më levronje ndë spjaxhire,
 amurë çë më dhuronje kurë stes
 bënja u, trim' i pārë. O tat, ku gjënde? 1010
 Pë motrën ndë këtë hërë e tim vullā!

Mëma të mbajti prapa e u të lë?
Jo, se s' dua dhuronjë pa tij u më.

Shën III
Bozdari e Morina

[*Mor*] U si lule e hapurëz
çë m' u lë ndë një madh sheshë, 1015
pra nga fjetat mjera u xhesh
aqë nga vapa çë dhuron.

Soset nata mbi të njize
e ata fjeta bardha o zeza
së ja hapën era o veza 1020
ç' ajo lutën e dishëron.

Nat e dit shërtonjë e qanjë
nj' ambnī çë nëng më vjën,
se noeret [ç'] me mua mbë'n
tek vendi, ani i rrësonjë. 1025

Një spjaxhīrë hjidhJORë shum
pather mua jushtron te gjiri.
Si një jëm kuj iku i biri
sa t' e gjënjë, llakat shurdhONjë.

Mosnjerī te pila o mali 1030
thirmes time u përgjegjë,
vetëm një meruame u gjegjë
çë si u pr' amurë u dogjë.

Ajo vet jo pak lipsjare
mua përgjegjet ndë thërres, 1035
vetme ajo me mua kā pjes
ndë strepī e këto zogjë.

Boz O qiellë, çë shoh ! Morina! Ajo më ndjet.
E njoh se është ajo, vërtet e njoh. Sonde
ndë gjum e pata e nditej se më thoj 1040
me thirmez hollë e ëmbëlë: më thelloi
akullin ndë stomachjë

e zëmrën m' e vëlomoi brënda ndë gjī.
Mor O Bozdarë, bën e losemi si dillë
me timin këshillë pather mbi tij, 1045
moj ti si malë i lart së ndikurone
nga bora [ç'] gjën ndë krah, kurë ndë menat
nga zeza nat lëshone.
Buzëqeshëme jam me tij ndë gjith mot
e ti m' e shehën pather tëndin sī. 1050
O vëdekje, o hjidhī, çë nëng më merr,
moj bën të jem e shqerr pather nga kī.
Nani ja thom një fjalë
e vëlomën buthtonjë çë prëhëri kā.
Boz O Morine, më prit, se prapa tij 1055
i lidhurë me një trëkuz ti, vashë, më siall
e u meruami vinjë ne zgjidhem dua,
moj qanjë sa një përrua e ti rrī ngurt
e së m' levron e farmkosurë do
të des, pa levronī, nga duartë tënde. 1060

Mor Mos më ngit, se nj' etri jam,
zëmrën mī nj' etri ja taksa.
U kurë pë tij u tramaksa
e ngë t' desha miri pik.

Ndë me sī ndodh' e më gjete 1065
o tek imja u fanaros
faqa jote, zëmra u los
ka trëmbimi e të tha: "Ik!".

Boz Si monosaqeshë çuf
ndë duarë një vashe jam, 1070
moj një pjaxhirë u s' kam
t' i puthinjë buzën edhe.

Më mban pather ndë diallë
njera më sfjetëson,
ndë truoll pra më lëshon, 1075
ndomos më shtie tutje.

U fjetat s' mund i mbanjë
se vezën s' kam ndë këmb

e diellit ngrohmi rrëmb
ndë kriet pather më dha. 1080

O sod o nesërë o dej
u des pr' atë spjaxhirë
çë vasha e fanmīrë
më jep prë mot e dha.

Shën IV

Axhezllai [e Trezja]

Axh O Trezje, më harrove. Shum të luta 1085

e prita ndë këtë jav, moj ti nëng erdhe
të më thonje ndë pate nga Neomen'ja
ndonjë nov' e mirë o ndëçë e pē gjakun,
se kā trī dit çë nëng e pē [e] thomse

gjë kā pasurë keqi, pse nga jashti 1090

ruojta sajin pullas e dritsoret gjith
si shpive të mbullitura
ishin, çë jan ndë lip e gjithnjëmoti
qari me një shërtim ndë qaf m' u hip.

Trez O zot, aylimono, ti spasitëtë 1095

të larta çë dhuruam fare ng' i xure?
U mëngu shpirt të t' i rrëfianjë kam,
se thirma sa t' vinjë ndë golë fuqī
u bënë e më ndë zëmrë më qëndron.
Nd' e xë, ti sot ngë rron prë lart spjaxhirë,
se illi it fanmirë tashë u verdhua. 1100

Axh Popo, Trezje, çë thua? U vete shoh
çë qe kjo madh hjidhī ç' ashtu i helëmoi
e fata fjuturoi ng' ana e saj.

Pse ndëçë vëdiqë, u des 1105

e dalë nga madhi ghuaj.

Shën V

Neomen'ja, Axhezllai

[Neom] O gjella ime zbjerr! Leva ndë dhë
të ndianj' aqë strepī sa një këshillë
pandehjurë nëng i kishë. O gī, via, ndahu;
zëmrë, lëshou ndë lot e, golë, ndë qārë; 1110

mushī, losu ndë djers, se gjete vrārë
 prindëtë e di vullezërë. O mëm, o tat!
 O vedekje pa zëmrë e pa lipsī,
 e pjot me lig rronī, nga jeta nxore
 katrë me një rrongat e mua më lë 1115
 e rrëmaksëme të gjegjinjë më trëmbim?
 U dunga rrī e qanjë
 e prindve nëng i mbanjë si [i] mbajti prapa
 vullezërve mëma e tata. O Axhezllā,
 ti vëdekjes librarte, kurë më gjete 1120
 te thesollea ndë malë, lidhurë ndë ndin,
 të bënja nj' etrë fin më lig e zī.
 O jet, o sprënx, o sī, se më ngë ju shoh!
 Drita u vrë, mali u err, llaka u nxī,
 prëhëri m' u brim e shpirti m' u bōrsua. 1125
 O mëm, ndë duart' e tua Neomen'jen prit,
 se vjen e nëng shkon prë të kjo dit.
 O fat, o amurë, o hërë, dërigo më mirë
 vulërë besjes çë zura, se ndomos
 u thashë me time duarë të hapinjë gjī'n 1130
 e zëmrën t' e ndanjë ndë nëng u los.
Axh O fat mallkuame, tas u ndënde allmëngu
 o rongën lutme edhe ngrëjturë e mban
 se të dërgoshë mb' at ān ndonjë etrë trim ?
 Mbaje se mua purton më të dhuronjë, 1135
 gjellës i siall nodhī. Sa më njinje
 mund më rrembeshë, rrëmbëm e shpirtin tek
 fanmiri saji është çë ndë dhë, sille,
 më mbajti gjatharë prë sa dhuroi.
 Sitë e tū të folëme, o Neomen'je, 1140
 ku van? Të verdha u bën e më ng' i priarë
 ndë qishë se të shëllqenjë autari e varri.
 Ngë bën e më qëndronjin ata trima
 pa fjalë e pa shpirt si dekurë nd' udhë
 ture sisuarë fōrmadhen bukurī 1145
 çë sillij faqa jote. O vashë harepsëme,
 buzqeshëmja gola jote ani ku vate?
 Ku vate i bardhi gjī
 çë qumbshtin vinxhoj, nd' i bëj jushtri?
 Fjala ëmbëlë jote çë shëroj 1150
 sëmurmet' e vëloruorë ngë ndihet më.

Kurmi pan jë stesje martoi me grop
e leshi tū arësuarë desh t' bënej hī
më parë se moti. O vëdekje, o hjidhī
mosparë prë sa dhuroi gjindja ndë dhē!
E pë vidhjen, e pë, çë ti mua vjove
e tashë çë ti më harrove, do t' vinjë
tek ë Neomen'ja e nxinjë kurmin e mī
me gjakëtë e saj. O vëdekje, o hjidhī!

1155

U sos

FRANCESCO ANTONIO SANTORI

NEOMÈNIA

Personaggi

Neomènia	<i>Ragazza albanese</i>
Agesilao	<i>Ragazzo che ama Neomenia</i>
Ifigènia	<i>Compagna di Neomenia</i>
Ermolao	<i>Amico e poi nemico geloso di Agesilao</i>
Teresa	<i>Messaggera di Agesilao</i>
Morinna	<i>Ragazza innamorata di Ermolao</i>
Bòsdare	<i>Ragazzo innamorato di Morinna</i>
Boleslao e Ladislao	<i>Fratelli di Neomenia</i>
Laomedonte ed Elena	<i>Genitori di Neomenia</i>
Turco	<i>Rapitore di Neomenia, non parlante</i>

PROEMIO

Desio novello mi induce a cantare
in versi non giocondi ma di lutto
la ventura di due che tolse morte
anzitempo ai viventi,
quasi invidia ne avesse e gelosia.
Più che di madre per figlia era tenero
il loro amor. Quando serbarlo prospero
pareva il fato e più gli consumava
in quella fiamma il cuore,
lor stella impallidì, fuggì la luce,

5

10

rovina incolse la casa di lei,
la lasciò desolata.
Il vecchio padre e la madre coi due
fratelli nella vita la precorsero
da cui non c'è ritorno 15
e poi, partita con appresso il giovane,
lei li raggiunse per non più venirsene.
Sventurata ragazza! Se il mio verso
potesse far durare a lungo in terra
la tua fama, no, non gli increocerebbe 20
faticoso travaglio.
Ma a tanto la mia penna
non vale e, dove il limite varcare
le si nega, s'arresta.

Atto I

Coro

Amor che il cuore agli uomini più volte 25
converse in nera fiamma e li lanciò
per ampia via malvagia,
dall'uno all'altro male rimandandoli,
finché, bendati strettamente, persero
il conto dei misfatti; 30
lui fece al mondo piangere le pene
e svelò quanto pesa questo fuoco
a chi, precipitato
nelle sventure, stenta ad aprir l'occhio
per scorgere quel putto 35
che, nudo, con un dardo solo in mano,
i robusti ferisce e non risparmia
vecchi, ragazze e giovani
e a lui nessuno viceversa nuoce
o almeno lo spaventa. 40
No, ché piccolo sembra e forza ha più
che tutto il mondo insieme.
Chi tra i viventi sfugge alla ferita
onde lo smunge Amore e lo dissangua?

Atto I
Scena I
Agesilao ed Ermolao

Ag Mai a te, Ermolao, dei miei segreti 45
il confidente, l'urna
fu celata del cuore.
Novella ora saprai però inattesa
o inaudita per quanto sei vissuto
dopo vista la luce. Ieri, stanco 50
del guerreggiar che un turco
mi fece per un tratto alla marina,
voltomi poi più su, sotto una quercia
il fianco stesi accanto
al cavallo e, come il sonno scese, 55
sognai mio padre che alle nozze indurmi
voleva in questi termini:
